

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Gjykata Supreme e Kosovës
Ap.-Kz. Nr. 466/2011
Prishtinë
10 korrik 2012

Gjykata Supreme e Kosovës në kolegjin e përbërë prej gjyqtarit të EULEX-it Gerrit-Marc Sprenger si kryetar i kolegjit dhe gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të Kosovës Nesrin Lushta e Salih Toplica si anëtarë të kolegjit, me ndihmën e Znj. Vlora Johnston si procesmbajtëse, më 24 nëntor 2009, në ndërtesën e Gjykatës Supreme, mbajti një seancë në përputhje me nenin 26 paragrafin (1) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), dhe nenin 15.4 të Ligjit mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë(LmK),

Në praninë e

Avokatit mbrojtës S. M. për të pandehurin B. D.;
Avokatit mbrojtës R. D. për të pandehurin M. G.
Avokatit mbrojtës A. A. për të pandehurin B. J.
Avokatit mbrojtës I. D. për të pandehurin S. Z.

Në lëndën penale me numër AP-KZ 466/2011 kundër të pandehurve:

B. D., shqiptar i Kosovës,

S. Z., shqiptar i Kosovës,

M. G., shqiptar i Kosovës,

B. J., shqiptar i Kosovës,

[REDACTED]

Në përputhje me aktgjykimin e shkallës së parë të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë në lëndën me numër P. Nr. 20/10 të datës 29 korrik 2011 dhe të regjistruar në Shkrimoren e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë në të njëjtën ditë, të **pandehurit u shpallën fajtorë, përkatësisht të pafajshëm për veprat penale në vijim:**

B. D. u shpall fajtor për veprë penale Mundësimi i prostitucionit sipas pikës 4 të aktakuzës, në shkelje të nenit 201 paragrafit 1 të Kodit Penal të Kosovës (KPK) dhe të ri-cilësuar nga kolegji në përputhje me nenin 391 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), sepse me dije ka rekrutuar, organizuar ose ndihmuar një person tjetër ose ia ka lëshuar lokalet një personi tjetër për qëllime të prostitucionit. Më saktësisht, **B. D.**, si pronar i klubit të natës "Victoria" në Gjakovë, gjatë periudhës kohore prej 2001 – 2008, rekrutoi, organizoi dhe ndihmoi një numër të grave me shtetësi të huaj për qëllime të prostitucionit, për shitjen e shërbimeve të tyre seksuale për shumta të ndryshëm parash klientëve të ndryshëm.

Prandaj, ai u dënua me 3 (tri) vjet burgim.

Të pandehurit **S. Z.**, **M. G.** dhe **B. J.** u shpallën të **pafajshëm** për akuzat nga pikat 1 dhe 2 të aktakuzës, që kanë të bëjnë me veprat penale Shpërdorim i pozitës zyrtare ose autorizimit nga neni 339 paragrafi 1 i KPK-së dhe Kontrabandim me migrantë nga neni 138 i KPK-së, kurse i pandehuri

B. D. u shpall i **pafajshëm** për akuzat nga pika 3 e aktakuzës, lidhur me veprën penale Pastrim i parave në përputhje me nenin 11.2 pikat (a), (b) dhe (c) të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/2 mbi Parandalimin e pastrimit të parave dhe veprave të ngjashme penale, të ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2004/53.

Avokati mbrojtës i të pandehurit **B. D.** brenda afatit ushtroi ankesë me datë 20 shtator 2011 kundër aktgjykimit. Edhe avokati tjetër mbrojtës i të pandehurit, **T. B.** brenda afatit ushtroi ankesë me shkrim kundër aktgjykimit të shkallës së parë më 22 shtator 2011. Pohohet se aktgjykimi përmban shkelje esenciale të procedurës penale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkelje të kodit penal dhe se duhet të kundërshtohet dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit. Është bërë propozim të ndryshohet aktgjykimi i kundërshtuar me lirimin e të akuzuarit nga të gjitha akuzat ose të prishet aktgjykimi dhe lënda të kthehet për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Prokurori Special i Kosovës (PSRK) po ashtu ushtroi me kohë ankesë me shkrim më datë 15 shtator 2011 kundër aktgjykimit të Gjykatës së dhe pohon se aktgjykimi përmban shkelje esenciale të procedurës penale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkelje të kodit penal. Është kundërshtuar në veçanti shpallja e të pandehurve **S. Z.**, **M. G.** dhe **B. J.** si të pafajshëm si dhe pjesërisht e të pandehurit **B. D.** dhe vendimi për lirimin e të pandehurve nga përgjegjësia për akuzat përkatëse nga aktakuza. Prandaj i propozohet Gjykatës Supreme

të Kosovës ta anulojë aktgjykimin e kontestuar në pjesën shfajësuese, dhe ta kthejë lëndën për rigjykim në gjykatën e njëjtë të shkallës së parë.

Avokatët mbrojtës të të pandehurve S [REDAKTUAR], Z [REDAKTUAR], M [REDAKTUAR] G [REDAKTUAR] dhe B [REDAKTUAR] J [REDAKTUAR] si dhe vetë i pandehuri B [REDAKTUAR] J [REDAKTUAR] iu përgjigjën ankesës së PSRK-së dhe propozuan që ankesa e PSRK-së të refuzohet dhe aktgjykimi i kundërshtuar i Gjykatës së Qarkut të vërtetohet.

Zyra e Prokurorit të shtetit të Kosovës (ZPShK), në përgjigjen e datës 15 dhjetor 2011 të regjistruar në Shkrimoren e Gjykatës Supreme të Kosovës më 19 dhjetor 2011 mbështet në tërësi ankesën e PSRK-së dhe propozon që Gjykata Supreme ta pranojë këtë ankesë, dhe t'i refuzojë ankesat e të pandehurit B [REDAKTUAR] D [REDAKTUAR] dhe avokatëve të tij mbrojtës.

Duke u bazuar në aktgjykimin me shkrim në lëndën e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë P. Nr. 20/10, të datës 29 korrik 2011, ankesat e parashtruara me shkrim nga i pandehuri dhe avokatët e tij mbrojtës, shkresat përkatëse të lëndës dhe parashtresat e tjera gojore të palëve gjatë seancës më 10 korrik 2012, bashkë me analizën e ligjit në fuqi, Gjykata Supreme e Kosovës, pas këshillimit më 10 korrik 2012, lëshon këtë:

AKTVENDIM

Ankesat e avokatëve mbrojtës të ushtruara në emër të të pandehurit B [REDAKTUAR] D [REDAKTUAR] dhe ankesa e Prokurorit Special të Republikës së Kosovës kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë P. Nr. 20/2010, të datës 29 korrik 2011, PRANOHEN. Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë ANULOHET dhe lënda KTHEHET PËR RIGJYKIM dhe vendosje.

ARSYETIMI

Historia e procedurës

1. Më 21 janar 2010 PSRK-ja ngriti aktakuzën (PPS Nr.462/2009) kundër B. J., M. G., S. Z. dhe B. D. si dhe kundër katër të pandehurve të tjerë (në veçanti F. K., F. H., B. O. dhe A. F.), e cila më vonë më 30 prill 2010 u ndryshua pas udhëzimit të gjyqtarit për konfirmim të aktakuzës.

Sipas aktakuzës së ndryshuar, të pandehurit e ndryshëm u akuzuan për vepra të shumëfishta penale, të cilat pretendohen se janë kryer në mes janarit 2007 dhe tetorit 2008. Të pandehurit B. J., M. G., S. Z., B. O. dhe F. H. pretendohen se ishin persona zyrtarë të Zyrës për Migrim në Prishtinë dhe pikën kufitare të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës. Pretendohet se në bashkëkryerje me njëri tjetrin dhe në cilësinë e tyre prej personave zyrtarë dhe me qëllim të përfitimit material të paligjshëm për vetvete dhe për të tjerët, u kanë mundësuar personave të huaj të hyjnë në Kosovë në mënyrë të paligjshme. Aktakuza saktësisht emëron tridhjetë e pesë (35) persona që pretendohet se kanë hyrë në Kosovë pa dokumentacion ose procedurë të duhur për shkak të veprimeve të pretenduara kriminale të të pandehurve. Shumica e madhe e imigrantëve ilegalë ishin femra nga Moldavia.

Të pandehurit B. J., M. G., S. Z., B. O. dhe F. H. secili u akuzuan për dy pika: Shpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit nga neni 339 i KPK-së dhe Kontrabandim me migrantë nga neni 138 i KPK-së.

Të pandehurit B. D., F. K. dhe A. F. secili u akuzuan për Mundësim të prostitucionit nga neni 201 paragrafi 3 i KPK-së. Në aktakuzë pretendohet se B. D. dhe F. K. secili ishin pronar të klubeve të natës në qytetin e Gjakovës dhe se gjatë viteve 2007 – 2008 ata rekrutuan, organizuan dhe ndihmuan dhe shfrytëzuan gjashtëmbëdhjetë (16) shtetase të Moldavisë të përmendura në mbështetje të prostitucionit. A. F. pretendohet se ka vepruar në bashkëkryerje duke “rezervuar” gratë për klientë të ndryshëm të cilët më pastaj u përfshinë në akte të prostitucionit me to.

Si plotësim, aktakuza ngarkon B. D. për veprë penale Pastrim parash nga neni 11.2 i rregullores së UNMIK-ut 2004/53 të ndryshuar me rregulloren e UNMIK-ut 2006/2.

2. Më 20 qershor 2010 u mbajt shqyrtimi për konfirmimin e aktakuzës. Gjyqtari për konfirmimin e aktakuzës hodhi poshtë aktakuzën kundër të pandehurve F. K. dhe A. F., kurse më 21 qershor 2010 nxori një aktvendim me të cilin hodhi poshtë pjesërisht aktakuzën sa i përket të pandehurve B. O. dhe F. H.,

por konfirmoi aktakuzën përkitazi me akuzat kundër të pandehurve B. J., M. G., S. Z. dhe B. D.

3. Aktvendimet për konfirmimin e aktakuzës më në fund u konfirmuan në tërësi nga kolegji prej tre gjyqtarëve të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë me aktvendimin e datës 29 dhjetor 2010, pasi prokurori i PSRK-së kishte ushtruar ankesa kundër tyre.

4. Shqyrtimi gjyqësor filloi përmes gjithsej shtatë seancave më 12 prill, 18, 19, 20, 21, 22 dhe 27 korrik 2011 përpara kolegjit të caktuar të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, ku u dëgjuan dëshmitarët policë N. Q., S. X. dhe Kapiteni i Policisë H. F.

Përveç kësaj, trupi gjykues pranoi këto prova: shënimet e porosive SMS të dërguara dhe të pranuar nga të pandehurit; raportin e përpiluar nga Kapiteni H. F. të datës 12 mars 2009; raportin e inspektimit në Zyrën e Migracionit dhe Departimit në Aeroport, të datës 25 prill 2009; raportin e inspektimit të dokumenteve në Drejtorinë e Migracionit, të datës 30 qershor 2009; raportin e Njësitit të Hetuesisë në Aeroportin e Prishtinës, të datës 01 korrik 2009; shkresat e fotokopjuara që kanë të bëjnë me hyrjen e pretenduar ilegale të qytetarëve të huaj të përmendur në aktakuzë si dhe atyre emrat e të cilëve ishin ndryshuar në aktakuzë gjatë gjykimit; shkresat e Drejtorisë së Migracionit të cilat janë të pakompletuara dhe përmbajnë gabime; kopjet e biletave dhe faqet e pasaportës së L. C.; raportet e transaksioneve financiare prej Western Union-it deri te rrjeti i Unionit Financiar në Prishtinë për të pandehurin B. D., dosjet financiare nga bankat e ndryshme në llogarinë bankare të B. J., S. Z. dhe M. G.; raportet e policit të Kosovës N. Q. të datës 10 maj 2007, 07 korrik dhe 12 shkurt 2009.

5. Më 22 korrik 2011, në përfundimin e shqyrtimit gjyqësor dhe menjëherë para fjalimeve përmbyllëse, prokurori i PSRK-së ndryshoi aktakuzën. Më saktësisht, prokurori ndryshoi pikën 1 të aktakuzës lidhur me veprën penale Shpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit, që tani pasqyron periudhën kohore prej janarit deri në dhjetor 2007, dhe jo periudhën e mëparshme kohore të akuzës prej janarit 2007 deri në tetor 2008. Për më shumë, prokurori ndryshoi emrat e shtetasve të huaj të cilët pretendohet se janë lejuar të hyjnë në Kosovë si pjesë e ndërmarrjes kriminale nga të pandehurit, nga lista fillestare prej tridhjetë e pesë personave në pesë personat në vijim: M. L., A. S., A. T., T. V. dhe T. T. Asnjëri nga këta persona nuk ishin emëruar në aktakuzën e parë. Pika 1 e aktakuzës së ndryshuar më tutje pretendon se të pandehurit në bashkëkryerje kanë pranuar ilegalisht në Kosovë një person të quajtur L. C.

Në kontekstin e njëjtë, prokurori i PSRK-së përveç kësaj e ndryshoi pikën 2 të aktakuzës për Kontrabandim me migrantë nga neni 138 i KPK-së, që tani pasqyron periudhën kohore prej janarit deri në dhjetor 2007, dhe jo periudhën e mëparshme kohore të akuzës prej janarit 2007 deri në tetor 2008.

Prokurori i PSRK-së e ndryshoi edhe pikën 4 të aktakuzës së parë lidhur me veprën penale të Mundësimit të prostitucionit nga neni 201 i KPK-së, duke i ndryshuar emrat e viktimave të pretenduara të veprës penale. Gjersa aktakuza e parë shënonte emrat e gjashtëmbëdhjetë (16) viktimave të pretenduara të prostitucionit, aktakuza e ndryshuar tani shënon po ashtu emrat e gjashtëmbëdhjetë names of sixteen (16) viktimave, prej të cilave vetëm dy prej tyre ishin shënuar edhe në aktakuzën e parë. Katërmëdhjetë (14) personat e tjerë të emëruar në aktakuzën origjinale janë zëvendësuar me emrat e katërmëdhjetë (14) personave tjerë, prej të cilëve pretendohet se të gjithë janë qytetarë të Moldavisë.

6. Avokati mbrojtës, Av. S [REDACTED] M [REDACTED], i të pandehurit B [REDACTED] D [REDACTED] ka parashtruar me kohë ankesë më 20 shtator 2011 kundër aktgjykimit. Gjithashtu, avokati tjetër mbrojtës i të pandehurit, Av. T [REDACTED] B [REDACTED], me kohë ka parashtruar ankesë me shkrim më 22 shtator 2011 kundër aktgjykimit të shkallës së parë. Është pohuar që aktgjykim përmban shkelje esenciale të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së kodit penal dhe që dënimi i shqiptuar të akuzuarit duhet të kundërshtohet. Është propozuar që të ndryshohet aktgjykimi i atakuar dhe që të lirohet i akuzuari prej të gjitha akuzave ose të priset aktgjykim dhe lënda ti kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

7. Prokurori Special i Kosovës (PSRK) gjithashtu me kohë ka parashtruar ankesë kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut dhe ka pohuar që aktgjykimi do të mund të përbënte shkelje esenciale të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe të shkeljes së ligjit penale, të gjitha që janë nënvizuar më lart.

8. Avokatët mbrojtës të të pandehurve S [REDACTED] Z [REDACTED], M [REDACTED] G [REDACTED] dhe B [REDACTED] J [REDACTED] e gjithashtu edhe vetë i pandehuri B [REDACTED] J [REDACTED] i janë përgjigjur ankesës së PSRK-së dhe kanë propozuar siç është vënë në pah më parë.

9. ZPSHK-ja në përgjigjen e tyre tërësisht kanë përkrahur aneksen e PSRK-së dhe kanë propozuar që të aprovohet nga Gjykata Supreme, por që të refuzohen ankesat e të pandehurit B [REDACTED] D [REDACTED] dhe të avokatëve të saj mbrojtës që u nënvizuan më lart.

GJETJET E GJYKATËS

A. Shkelje substanciale e dispozitave të procedurës penale

10. PSRK-ja – e përkrahur nga ZPSHK-ja – e gjithashtu avokati mbrojtës, Av. S [REDACTED] M [REDACTED], i të pandehurit B [REDACTED] D [REDACTED] kanë atakuar aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut për shkeljen e pretenduar të nenit 403 paragrafit 1 pikës 12 të KPPK-së, për shkak të kontradiktave të konsiderueshme në mes të arsyetimit të aktgjykimit, i cili – përkundër që nuk do të mund të pasqyrojë faktet përfundimtare të vërtetuara – mundet gjithashtu që të mos jetë në linjë me përmbajtjen e dokumenteve dhe të dhënave mbi deklaratimet që janë dhënë gjatë seancave dëgjimore. Në veçanti, arsyetimi i aktgjykimit mund të mos pasqyrojë deklaratën e dëshmitarit N [REDACTED] Q [REDACTED], sipas të cilit të dhënat lidhur me

viktimën e pretenduar L. C. janë gjetur në kompjuter të pandehurit M. G., i cili është akuzuar në kontekst të lëshimit të letërnjoftimeve ilegale. Për më tepër dhe përveç tjerash, sipas raportit të dëshmitarit të njëjtë të datës 10 maj 2007, viktima e pretenduar L. C. i ka dërguar përmes faksit letërnjoftimin e saj të Moldavisë të pandehurit B. J., i cili më 15 janar 2007 dhe në bazë të informatave të marra nga ai letërnjoftim e ka lëshuar letërnjoftimin e UNMIK-ut për L. C. me numër personal 2911147001, por pa praninë dhe nënshkrimin e L.

11. Sipas PSRK-së, Gjykata e Qarkut ka bërë shkelje të nenit 403 paragrafit 2 pikës 1 të KPPK-së e lidhur me nenin 164 paragrafin 2 të KPPK-së, sepse pas aprovimit të propozimit të prokurorit për të dëgjuar dëshmitarët zyrtarët e PK-së S. X. dhe N. Q., gjykata nuk i ka lejuar dëshmitarët që të deklarohen lidhur me deklaratat e palës së dëmtuar A. J. që i kishte dhënë këtyre zyrtarëve. Gjykata nuk ka pasur të drejtë të kufizojë deklaratat e dëshmitarëve.

12. Avokatët mbrojtës të pandehurit B. D. për më tepër kanë theksuar që aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut mund të përmbaj shkelje substanciale të dispozitave të Procedurës Penale në veçanti sa i përket nenit 403 paragrafit 1 pikës 8 të KPPK-së, por pa dëshmuar pretendimet e tyre.

I. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 403 PARAGRAFIT 1 PIKËS 12 TË KPPK-së:

13. Gjykata Supreme e Kosovës në të vërtetë konstaton që dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është i pamjaftueshëm në së paku disa pjesë dhe që aktgjykimit të atakuar i mungon arsyetimi i mjaftueshëm që tërësisht do të pasqyronte dispozitivin.

1. Përfshirja e të pandehurit Bib DOQAJ:

14. Duhet të lihet e hapur që në fazën aktuale të procedurës nëse i pandehuri B. D. ka qenë apo jo i përfshirë në veprën penale Mundësimi i Prostitucionit sipas nenit 201 të KPK-së nëse prova e paraqitur – për dallim nga gjetjet e Gjykatës së Qarkut – do të mjaftonte për ta shpallur atë fajtorë gjithashtu për veprën penale Pastrim i Parave sipas nenit 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/2 e ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2004/53.

15. Lidhur me veprën penale të Mundësimi të Prostitucionit megjithatë duhet të nënvizohet që lëndën në fjalë arsyetimi i aktgjykimit të atakuar të Gjykatës së Qarkut e bazon fajësinë e B. D. ekskluzivisht në disa mesazhe elektronike, të cilat janë dërguar në celularin e tij nga numra të ndryshëm telefonik, secili duke kërkuar rezervimin për 'L.', 'M.', 'M.', 'L.', 'M.' ose 'L.', të cilat pretendohet që janë femra dhe që dërguesit e mesazheve dëshironin t'i takonin. Aktgjykimi i atakuar në arsyetimin e tij i mungon qartësimi i identitetit të personave pas nofkave të

lartpërmendura dhe nuk ofron asnjë vlerësim nëse ato janë identike me viktimat e pretenduara nga aktakuza. Arsyetimi i aktgjykimit të kundërshtuar për më tepër gjithashtu nuk përmban asnjë fjali lidhur me deklaratat e vetë viktimave të pretenduara dhe nëse këto deklarata apo jo korrespondojnë me përmbajtjen e mesazheve kështu duke i vërtetuar ato prandaj së bashku me të do të mund të shfaqnin kërkesat ligjore të nenit 201 paragrafit 1 të KPK-së.

16. Sa i përket ri-cilësimit të veprës penale Mundësimi i Prostitucionit sipas nenit 201, me të cilin i pandehuri B. D. fillimisht është akuzuar me paragrafin 3 të këtij neni dhe të shpallurit të tij fajtorë nga Gjykata e Qarkut për të njëjtën veprë penale por tani sipas paragrafit 1 të nenit, arsyetimi i aktgjykimit të kundërshtuar gjithashtu nuk përmban asnjë fjali. Referencë e dobët në ri-cilësim në dispozitivit përmes vetëm një gjysmë fjalie fare nuk është e mjaftueshme.

17. Sa i përket veprës penale të Pastrimit të Parave në pajtim me neni 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/2 e ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2004/53, i pandehuri B. D. nuk është shpallur fajtorë prandaj edhe është liruar nga të gjitha akuzat përkatëse të aktakuzës, por pa e përshkruar veprën me të cilën ai është akuzuar, siç ofrohet nga neni 396 paragrafit 4 të KPPK-së. Gjithashtu, arsyetimi përkatës është tërësisht i pamjaftueshëm, vetëm duke ofruar që " *Prokuroria nuk ka arritur të dëshmojë akuzën e Pastrimit të Parave përtej dyshimit të bazuar. Kolegji kurrë nuk ka pranuar ekspertizën financiare dhe nuk ka kurrfarë dijenie për qarkullimin e të hollave të afarizmit të B. D., të klubit të natës "Viktoria". Ky kolegji nuk do të hamendësoj apo supozoj faktet që nuk janë paraqitur gjatë gjykimit*" (faqe 9 e aktgjykimit të kundërshtuar në versionin e gjuhës angleze).

2. Përfshirja e të pandehurve B. J., M. G. dhe S. Z.:

18. Gjithashtu, mund të lihet e hapur në këtë pikë, nëse i pandehuri M. G. ishte apo jo i përfshirë në ofrimin e dokumenteve false të identifikimit të viktimës L. C. ose nëse apo në cilën mënyrë ai mund të ketë qenë i përfshirë në kontrabandimin e saj në Kosovë. Gjithashtu nuk duhet të vlerësohet përfundimisht, nëse i pandehuri B. J. personalisht apo jo ka lëshuar letërnjoftim të UNMIK-ut për atë viktimë më 15 janar 2007 me numrin personal 2911147001, por pa praninë dhe nënshkrimin e saj, siç është theksuar nga PSRK-ja në ankesën e tyre. Gjithashtu, roli dhe përfshirja e të pandehurit S. Z. nuk duhet të vlerësohet në këtë fazë të procedurës. Megjithatë, arsyetimi i aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut nuk pasqyron në mënyrë të mjaftueshme vlerësimin e provave lidhur me pjesëmarrjen e mundshme kriminale të të pandehurve për veprat penale të cilat i vihen në barrë.

19. Gjithashtu, sa i përket të pandehurve të lartpërmendur, dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar duke i shpallur të pandehurit të pafajshëm i mungon përshkrimi i veprave me të cilat janë akuzuar, siç ofrohet në nenin 396 paragrafin 4 të KPPK-së.

20. Arsyetimi i aktgjykimit të kundërshtuar është në përgjithësi më mënyrë ekstreme i hollë dhe nuk është në linjë me kërkesat e ligjit. Përderisa arsyetimi i konsiderueshëm i cili nuk përmban më shumë se në total katër faqe, ofron një numër të pretendimeve dhe pohimeve d.m.th.: që ishte i pandehuri B. J. i cili i ka proceduar kërkesat në emër të viktimave M. L., A. S., A. T. dhe T. V. dhe që i pandehuri M. G. procedoi kërkesën e viktimës T. T., aktgjykimi në përgjithësi nuk bindet nenit 396 paragrafëve 6 dhe 7 të KPPK-së, i cili sado që të jetë relevant këtu përcakton si në vijim:

(6) Gjykata në arsyetimin e aktgjykimit paraqet arsytet për çdo pikë të aktgjykimit.

(7) Gjykata paraqet qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsytet i konsideron të vërtetuara apo të pavërtetuara si dhe arsytet për këtë. Gjykata gjithashtu në mënyrë të veçantë vlerëson saktësinë e provave kundërthënëse, arsytet e mosmiratimit të propozimit konkret të palëve, si dhe arsytet në të cilat është bazuar me rastin e zgjidhjes së çështjeve juridike [...].

21. Arsyetimi i aktgjykimit të kundërshtuar për më tepër i mungojnë tërësisht të dyja, vlerësimi individual dhe i përngjithshëm i provave, siç është parashikuar nga neni 387 paragrafi 2, duke përcaktuar që “Gjykata detyrohet që me ndërgjegje të vlerësojë çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera dhe në bazë të vlerësimit të tillë të nxjerrë përfundim nëse fakti konkret është provuar”.

II. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 403 PARAGRAFIT 2 PIKËS 1 TË KPPK-së:

22. Me të vërtetë nuk është e besueshme pse Gjykata e Qarkut në seancën e saj të datës 19 korrik 2011 (faqja 13 e procesverbalit) nuk e ka lejuar dëshmitaren S. X. zyrtare policore e PK-së të deklarohet lidhur me deklaratën me shkrim të viktimës së pretenduar A. J. e dhënë në polici më 27 qershor 2008. Edhe pse vetë viktima nuk ka qenë në dispozicion gjatë shqyrtimit gjyqësor, PSRK-ja ka paraqitur deklaratën e saj, e cila është përfshirë në shkresë të lëndës por nuk është përkthyer në gjuhën angleze, si provë.

B. Vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike

23. Për më tepër, PSRK-ja – përsëri e përkrahur nga ZPShK-ja – ka theksuar që Gjykata e Qarkut nuk e ka vërtetuar gjendja faktike në mënyrë të duhur. Në veçanti, Gjykata nuk e ka marrë parasysh që sipas raportit inspektues të SPK – Aeroporti, të datës 12 mars 2009 dhe të nënshkruar nga dëshmitari kapiten H. F., i pandehuri B. J. ishte sjellë disa herë në lidhje me aktivitetet kriminale përkatëse. Gjithashtu, kopjet e shkruara të përgjimit të telekomunikimit në mes të të pandehurve B. J. dhe B. D. e gjithashtu në mes të pandehurit M. G. dhe personave tjerë pjesërisht të panjohur nuk është marrë parasysh në mënyrë të duhur nga gjykata.

24. Veç kësaj, Gjykata e Qarkut nuk ka marr parasysh faktin që nënshkrimet e viktimave të pretenduara L M, A S, A T, T V dhe T T në formularët e kërkesave për hyrje në Kosovë – edhe pse nuk është vërtetuar nga ekspertiza grafologjike – janë qartësisht të ndryshme prej atyre në kontratat e tyre të punës.

25. Gjithashtu, avokatët mbrojtës të pandehurit B D kanë theksuar që aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut mund të përmbaj vërtetim të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Në kontekstin e dhënë, në veçanti avokati mbrojtës, Av. S M ka theksuar që asnjë provë nuk është vërtetuar nga gjykata për të pandehurin që i pandehuri B D ndonjëherë ka detyruar punëtorët e tij femra që të ushtrojnë prostitucion ose që ai përndryshe ia ka kufizuar lirinë e tyre të lëvizjes. Gjithashtu, ushtrimi i prostitucionit nga femrat që punojnë në klubin e natës të pandehurit nuk janë vërtetuar fare. Pesë punëtorët e huaja në klubin e natës të të pandehurit, 'Viktory' në Gjakovë, kanë qenë të pajisura me kontratat e punës dhe me letërnjoftime të përkohshme të UNMIK-ut. Qasja e tërësishme e Gjykatës së Qarkut lidhur me këtë ka bërë shkeljen e parimit 'gjykim i drejtë' siç përcaktohet në nenin 6 paragrafit 3 të Konventës Evropiane të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KEDLNj).

26. Gjykata Supreme e Kosovës në të vërtetë gjen se asnjë vlerësim i duhur dhe i plotë i fakteve nuk është ofruar nga Gjykata e Qarkut, e gjithashtu lidhur me përfshirjen e pretenduar të pandehurit B D në akuzat penale të Mundësimit të Prostitucionit dhe të Pastrimit të Parave dhe në lidhje me të pandehurit B J, M G dhe S Z në veprat penale Kontrabandim me Migrantë dhe Keqpërdorimi i pozitës zyrtare apo autoritetit që atyre u vihen në barrë.

Pothuajse kurrfarë energjie nuk është investuar në vlerësimin e provave dhe fakteve të paraqitura lidhur me rolin e të pandehurve.

27. Lidhur me përfshirjen e të pandehurit B D në veprën penale të Mundësimit të Prostitucionit sipas nenit 201 paragrafit 1 të KPK-së asnjë vlerësim i duhur i provave nuk është kryer lidhur me deklaratat e viktimave të pretenduara siç është nënvizuar më herët. Lidhur me akuzat e Pastrimit të Parave, Gjykata e Qarkut në mënyrë të panevojshme ka fshirë pretendimet e prokurorisë, sepse gjykata – në mënyrë të kundërt nga obligimet e veta sipas nenit 7 paragrafit 1 të KPPK-së – nuk ka qenë e gatshme që lëndën të hetojë në mënyrë më të kujdesshme dhe të mbyll zbrazëtirat e pretenduara në vërtetimin e fakteve.

28. Sa i përket të pandehurve B J, M G dhe S Z gjykata në mënyrë pothuajse të përpunuar thekson në aktgjykimin e saj të kundërshtuar që *"asnjë provë nuk është ofruar gjatë gjykimin lidhur me pasaktësinë e pretenduar në shkresa lidhur me M L, A S, A T, T V ose T T"* (faqe 7 e aktgjykimin të kundërshtuar në versionin në gjuhën angleze).

29. Duhet të theksohet në kontekstin e dhënë se në veçanti sipas nenit 7, par. 1 të KPPK-së “gjkata [...]të cilët marrin pjesë në procedurën penale detyrohen që saktësisht dhe tërësisht t’i vërtetojnë faktet që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm”. Çfarë nënkupton kjo përshkruhet në hollësi në paragrafin 2 të të njëjtit nen, sipas të cilit gjykata “detyrohet që me vëmendje dhe me përkushtim maksimal profesional dhe me përkujdesje të njëjtë të vërtetojnë faktet kundër të pandehurit si dhe ato në favor të tij, [...] para fillimit të procedurës dhe gjatë zhvillimit të saj”. Nënkuptohe vetvetiu se këto përkushtime dhe hapa të gjykatës më vonë duhet të pasqyrohen në aktgjykimin e nxjerrë, siç edhe mund të kuptohet nga neni 8, par. 2 si dhe nga neni 360, par. 1 i KPPK-së.

30. Përderisa Gjykata Supreme lidhur me pohimet e PSRK-së në ankesën e tyre, konstaton se nënshkrimet e viktimave të pretenduara L M, A S, A T, T V dhe T T në formularët e aplikacioneve për të hyrë në Kosovë në shikim të parë duken të jenë identike me nënshkrimet e tyre në kontratat e punës (duke pasur parasysh se kontrata e punës së T T nuk ka fare nënshkrim të saj) dhe se ekspertiza grafologjike nuk duket të jetë fare e dobishme apo e mundshme, duke pasur parasysh se në dispozicion kanë mbetur vetëm pak nënshkrime por jo edhe pjesë të tekstit, faktet e tjera kanë mundur të provohen shumë më mirë sesa që është bërë nga Gjykata e Qarkut.

31. Gjykata e Qarkut në veçanti nuk ka ndërmarrë hapat e nevojshëm si në vijim me qëllim të vërtetimit të fakteve të rëndësishme:

- Me qëllim të vërtetimit të përgjegjësisë penale të të pandehurve B J, M G dhe S Z për veprën penale të shpërdorimit të pozitës zyrtare ose autorizimit sipas nenit 339 të KPK-së dhe lidhur me veprën e pohuar të kontrabandimit me migrantë sipas nenit 138, par. 1 dhe 3 të KPK-së të cilat është dashur që në fillim të kuptojnë sistemin e kodeve të PIN-it dhe të sistemeve të tjera regjistruese administrative siç përcaktohet me raportin inspektues të SPK-së – Aeroportit, të datës 12 mars 2009 dhe të përshkruar në mënyrë të pjesshme me kërkesë të gjykatës nga dëshmitarët N Q gjatë seancave gjyqësore të datës 18 dhe 19 korrik 2011 dhe nga H F gjatë seancës gjyqësore të datës 21 korrik 2011.
- Pasi që aspekti më i rëndësishëm në të dyja lëndët janë kushtet subjektive të “dashjes për të përfituar dobi të kundërligjshme pasurore” për kryerësin apo personin e tretë, duke kërkuar shenja me qëllim të provimit apo së paku rritjes së mundësisë për një dashje të tillë, do të duhej të ishin detyra të obligueshme për gjykatën. Në veçanti këtu përmendet dosja e plotë e shkresave të lëndës e cila përmban informata të hollësishme lidhur me disa xhirollogari bankare të të pandehurve si dhe për transferimin e këtyre parave nëpër ato xhirollogari po ashtu edhe gjatë periudhës kohore të përmendur në aktakuzë. Në disa raste, në veçanti kur kemi të bëjmë me të pandehurit B J dhe M G ajo që bie dukshëm në sy është se herë pas here janë transferuar shuma më të mëdha të të hollave (afërsisht prej 1500 deri në 5000 euro) në këto xhirollogari bankare apo

janë tërhequr prej tyre, përderisa paga e të pandehurve si policë nuk ka qenë më e lartë sesa rreth 250 euro në muaj, pa dhënë asnjë arsyetim lidhur me këto transferime të parave në shuma të tilla. Rasti do të ndriçohet mjaft shumë po qe se do të kishim idenë prej nga vinin këto shuma të larta parash si dhe nëse të njëjtat u ishin vënë në dispozicion të të pandehurve në kontekstin kohor të përafërt me hyrjen e viktimave të pohuara në Kosovë pa pasur dokumentacion të rregullt.

- Vlerësimi i transkriptit të përgjimeve të telekomunikimit dhe të regjistrimit të mesazheve me tekst në mes të të pandehurve B. J. dhe B. D. si dhe në mes të të pandehurit M. G. dhe të tjerëve – pjesërisht të panjohur – persona këta të cilët nuk janë trajtuar si duhet nga gjykata por të cilët do të kishin mundur të hidhnin edhe më shumë dritë në këtë lëndë si dhe lidhjet në mes të të pandehurve, gjë e cila gjithashtu nuk është bërë fare nga gjykata në fjalë.

C. Shkelja esenciale e ligjit penal

32. PSRK-ja – e mbështetur nga ZPShK-ja – ka kundërshtuar aktgjykimin e sjellë nga Gjykata e Qarkut për shkelje të pohuara të ligjit penal. Në veçanti, për dallim nga pohimet e aktgjykimit të kundërshtuar, prokurori do ta kishte të drejtën e përmirësimit dhe precizimit qoftë edhe të aktakuzës së konfirmuar, vetëm pa ndryshuar cilësimet juridike. Në mënyrë specifike, gjykata nuk kishte zbatuar si duhet dispozitat e nenit 339, par. 1 të KPK-së (shpërdorim të pozitës zyrtare ose autorizimit), që nuk kërkon që kryerësi vërtetë të përfitojë ndonjë dobi pasurore për veten e vet apo për ndonjë person tjetër, por kërkon vetëm të ketë pasur si qëllim një gjë të tillë. E fundit jo më pak e rëndësishme është se Gjykata e Qarkut kishte shpallur fajtor të pandehurin B. D. për veprën penale mundësim të prostitucionit sipas nenit 201, par. 1 të KPK-së, përderisa i pandehuri në fjalë është ngarkuar me të njëjtën vepër në aktakuzë, porse sipas nenit 201, par. 3 të KPK-së. Sidoqoftë, aktgjykimet i referohen nenit 201, par. 1 të KPK-së në faqen 3 të versionit në gjuhën angleze, përderisa në faqen 2 të të njëjtit version referimi i bëhet nenit 201, par. 3 të KPK-së.

33. Po ashtu, avokatët mbrojtës të të pandehurit B. D. kanë theksuar se aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut përmbante shkelje të ligjit penal. Në veçanti, gjykata kishte shpallur të pandehurin fajtor për veprën penale të mundësimit të prostitucionit sipas nenit 201, par. 1 të KPK-së pa vërtetuar asnjë fakt.

I. AUTORIZIMI I PROKURORIT PËR TA NDRYSHUAR AKTAKUZËN:

34. Sa u përket ndryshimeve të bëra në aktakuzës nga ana e prokurorit gjatë seancës së datës 22 korrik 2011, Gjykata Supreme i referohet nenit 376, par. 1 të KPPK-së, sipas të cilit prokurori, në qoftë se “*gjatë shqyrtimit gjyqësor konstaton se provat e shqyrtuara tregojnë*” një gjendje tjetër faktike nga ajo e përshkruar në aktakuzës, atëherë i njëjti “*gjatë shqyrtimit gjyqësor mund ta ndryshojë aktakuzën gojarisht dhe mund të propozojë që shqyrtimi gjyqësor të ndërpritet për përgatitjen e aktakuzës së re*”.

Edhe pse nëse veprimet e ndërmarra në këtë lëndë kanë qenë apo jo të mjaftueshme dhe racionale mbetet një çështje e hapur, prokurori më 22 korrik 2011 në veçanti iu ka referuar emrave të ri të viktimave të pohuara, të cilët në mënyrë ekskluzive dalin nga listat e transferimeve të parave, të siguruara nga Western Union dhe të prezantuara si provë në gjykatë gjatë shqyrtimit gjyqësor. Në vend të tërheqjes së aktakuzës tashmë të konfirmuar si dhe ngritjes së një aktakuzë tjetër të re – të ndryshuar në vend të saj (e cila edhe pse do të kërkonte më shumë punë intensive do të kishte qenë e rekomanduar në interes të një hapi të qartë procedural i cili nuk do të shkaktonte huti) prokurori i ka dorëzuar gjykatës ndryshimet e bëra gojarisht në formë të shkruar si ‘fjalë përfundimtare’ (PPS nr. 426 / 2009), të datës 22 korrik 2011.

Duhet të mbetet e hapur çështja nëse një veprim i tillë, edhe po qe se interpretohet në përputhje me kushtet ligjore, ka fare kuptim apo thjesht ka si qëllim të rrisë hutimin e shkaktuar.

II. PRETENDIMI MBI ZBATIMIN E GABUAR TË LIGJIT PENAL LIDHUR ME B [REDAKTUAR] J [REDAKTUAR] M [REDAKTUAR] G [REDAKTUAR] DHE S [REDAKTUAR] Z [REDAKTUAR]:

35. Megjithatë, duke pasur parasysh mangësitë e aktgjykimit të kundërshtuar siç u theksua më lart nën aspektin e vërtetimit gjoja të gabuar dhe jo të plotë të fakteve, një analizë e drejtë dhe e plotë si dhe vlerësim i provave të ofruara lidhur me aktivitetet e pohuara të të pandehurit B [REDAKTUAR] D [REDAKTUAR] në mundësimin e prostitucionit dhe pastrimin e parave dhe në veçanti rreth transferimeve të parave në xhironlogaritë bankare të të pandehurve B [REDAKTUAR] J [REDAKTUAR], M [REDAKTUAR] G [REDAKTUAR] dhe S [REDAKTUAR] Z [REDAKTUAR] në kuptim të rezultateve të raporteve mbi hetimet e brendshme mund të shpie tek një tjetër cilësim juridik i shumicës së veprave dhe aktiviteteve penale të kryera në lëndën në fjalë.

D. Vendimi mbi dënimin

36. Të dy avokatët mbrojtës të të pandehurit B [REDAKTUAR] D [REDAKTUAR] kanë theksuar se vendimi mbi dënimin do të ishte i padrejtë. Avokati mbrojtës S [REDAKTUAR] M [REDAKTUAR] ka theksuar se vendimi mbi dënimin është marrë pa konsideruar fare rrethanat lehtësuese dhe se për këtë arsye i pandehuri ka marrë dënimin më të rëndë të mundshëm në bazë të ligjit.

37. Gjykata Supreme konstaton se Gjykata e Qarkut vërtet ka bërë vetëm një vlerësim shumë të shkurtër të rrethanave lehtësuese dhe rënduese në rastin e të pandehurit B [REDAKTUAR] D [REDAKTUAR] (faqe 10 e aktgjykimit të kundërshtuar në versionin në gjuhën angleze) dhe se arsyetimi përkatës nuk është më i gjatë sesa 13 rreshta (në gjuhën angleze). Për më tepër, vërtet dënimi prej tre (3) vjetësh burgim i shqiptuar ndaj të pandehurit B [REDAKTUAR] D [REDAKTUAR] është dënimi më i lartë i mundshëm sipas nenit 201, par. 1 të KPK-së. Megjithatë, nuk është bërë asnjë vlerësim përfundimtar rreth dënimin të shqiptuar në lëndën në fjalë, pasi që

rigjykimi i tërë kësaj lënde si dhe marrja parasysh e të gjitha aspekteve të adresuara më herët do të mund të shpinte në një vendim krejt tjetër mbi dënimin.
Për të gjitha këto arsye, Gjykata Supreme ka vendosur si në dispozitiv.

Anëtarët e kolegjit:

Nesrin Lushta
Gjyqtare e Gjykatës Supreme

Salih Toplica
Gjyqtar i Gjykatës Supreme

Kryetar i kolegjit:

Procesmbajtës:

Gerrit-Marc Sprenger
Gjyqtar i EULEX-it

Holger Engelmann
Zyrtar ligjor i EULEX-it

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
Ap. - Kž. Nr. 466 / 2011
Prishtinë
10 korrik 2012